



**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 1, datë 22.02.2023

PËR

**SHPALLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM NË KONKURSIONIN E TEKSTEVE
MËSIMORE PËR DIASPORËN,
NIVELI II DHE NIVELI III**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, “Për organizimin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrin nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën” dhe Urdhrin/Vendimin e Përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, “Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.

VENDOSI:

Shpalljen e thirrjes për aplikim në konkursin e teksteve mësimore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë, “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, niveli II” dhe “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, niveli III”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj

Z. Arbër Salihi

Z. Ymer Avdiu

Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Znj. Feime Llapashtica Lipsomb

Znj. Evis Mastori

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi